

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"AQUA PARK" SH.P.K.**

Sot me date 19.11.2020, me ane te ketij dokumenti, te hartuar ne 4 (kater) kopje origjinale, ortaket e shoqerise:

**Z. Pullumb Mene**, i datelindjes 11.01.1936, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. **024481948**, dhe numer personal **D60111037C**, i cili zoteron **40 % te aksioneve shoqerise "AQUA PARK" SH.P.K.**,

**Z. Devi Mene**, i datelindjes 23.07.1992, lindur dhe banues ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. **026761995**, dhe numer personal **J20723071U**, i cili zoteron **30 % te aksioneve te shoqerise "AQUA PARK" SH.P.K.**,

**Z. Klajdi Mene**, i datelindjes 12.01.1988, lindur dhe banues ne Tirane, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. **026547740**, dhe numer personal **I80112062W**, i cili zoteron **30 % te aksioneve te shoqerise "AQUA PARK" SH.P.K.**,

Deklaruan se aktiviteti i shoqerise **"AQUA PARK" SH.P.K.**, do te rregullohet, organizohet dhe zhvillohet ne perputhje me kerkesat e Ligjit, Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

1) Ky Akt-Themelimi dhe Statuti bashkalidhur jane pregatitur konforme kerkesave te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

2) Kohezgjatja e aktivitetit fiksohet per nje periudhe kohe te pakufizuar.

3) Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Dhënie me qira e ambienteve në pronësi të Shoqërisë;
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e argëtimit, nëpërmjet koncerteve, diskotekave, pishinave të hapura apo të mbyllura, kënde lojrash për fëmijë, sallave të përgatitjes fizike, aparaturave të teknologjisë së lartë;
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e hotelerisë;
- Ofrimi i shërbimeve në fushën e ushqimit nëpërmjet restoranteve, ëmbëltoreve, kafeneve etj.
- Dhënie dhe ofrim shërbimesh, konsulencë dhe asistencë me staf të specializuar për të tretë për këto çështje dhe pa u kufizuar në to, si mbajtje kontabiliteti, drejtim marketingu, konsulencë ligjore, art dizajn etj.;
- Organizimi, promovimi, koordinimi dhe drejtimi i aktiviteteve në fushën e biznesit prodhues shqiptar;
- Kryerja e punimeve në fushën e ndërtimit të objekteve civile, industriale e turistike, prodhimi i materialeve inerte prej guri, rëre, cakulli dhe prodhim qeramike, tulle dhe

parafabrikate, prodhim e tregtim të elementeve betonarme, prodhim dhe tregtim të materialeve të imëta, të gatshme dhe gjysëm të gatshme;

- Blerja, shitja dhe administrimi i pasurive të patundshme të cilat janë në interes të Shoqërisë.
- Kryerja e shërbimeve të mirembajtjes etj;

4) Per permbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në bashkëpunim me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtte ose të përafert me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet e nevojshme për realizimin e objektit të saj.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhese në leke apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, konform legjislativës në fuqi.

5) Selia e shoqërisë është në adresën: Autostrada Tirane – Durres, km 12, Gjakaj, ndodhur në zonën kadastrale nr.1167, Tirane.

Asambleja si dhe organet e administrimit, kanë kompetencë të hapin filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbyllë, sipas cmuarjes dhe gjykimit, që ato i bëjnë çdo rast.

6) Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet vetëm nga kontribute në para dhe është 100 000 leke. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë (një) kuotë me vlerë nominative 100 000 leke. Kuota në përqindje e ortakeve në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

**Z. Pullumb Mene**, i datelindjes 11.01.1936, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. **024481948**, dhe numer personal **D60111037C**, i cili zotëron **40 % të aksioneve shoqërisë "AQUA PARK" SH.P.K., e barabartë me shumën 40.000 leke.**

**Z. Devi Mene**, i datelindjes 23.07.1992, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. **026761995**, dhe numer personal **J20723071U**, i cili zotëron **30 % të aksioneve të shoqërisë "AQUA PARK" SH.P.K., e barabartë me shumën 30.000 leke.**

**Z. Klajdi Mene**, i datelindjes 12.01.1988, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. **026547740**, dhe numer personal **I80112062W**, i cili zotëron **30 % të aksioneve të shoqërisë "AQUA PARK" SH.P.K., e barabartë me shumën 30.000 leke.**

7) Administrator i shoqërisë, i emëruar për një periudhë kohe 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi është **Z. Klajdi Mene**, i datelindjes 12.01.1988, lindur dhe banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit nr. **026547740**, dhe numer personal **I80112062W**;

Ai ka të drejtën e firmës dhe të përfaqësimit të shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të emërojë edhe Administratore të tjera.

Administratori gëzon kompetencë të pakufizuar për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që janë ngarkuar asamblese së përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tij mund të vërë në levizje instancë juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke leshuar prokurë në rastë gjyqësor, të kryejë

operacione bankare, perfshire ketu edhe hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher-xhirimi, tituj krediti, paradhenie krediti.

Administratori ne perfundim te cdo viti ekonomik perpilon nje relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektiven e shoqerise, si dhe pergatit bilancin perfundimtar qe ia paraqet cdo vit Asamblese per aprovim.

8) Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

9) Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali themeltar, vlera e kontributit dhe kuota e ortakut te vetem.

Ne perfundim te vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, Asamblea pasi ka ndare fondet per likuidimin e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos per ndarjen e fitimit neto. Per humbjet pergjigjet eskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj.

10) Ortaket mund ta zmadhojne kontributin e tij dhe si pasoje edhe kouten e tij, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerise, konforme asaj se parashikuar ne Statutin e shoqerise.

11) Ortaket dhe Administratori jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjesisht.

Ata jane pergjegjes per pasojat negative qe mund te vijne nga shkelja e dispozites se mesiperme. Sa me siper vlen edhe edhe per Ekspertin Kontabel te Regjistruar.

Ortaket jane pergjegjes, ndaj te treteve per demet qe mund t'u shkaktohen nga anullimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelues.

Per sa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur.

Njekohesisht me nenshkrimin e ketij Akti, ortakët nenshkruan edhe Statutin e shoqerise "AQUA PARK" SH.P.K., i cili i bashkalidhet aktit te themelimit dhe eshte pjese perberese e tij.

### ORTAKET E SHOQERISE

PULLUMB MENE



DEVI MENE



KLAJDI MENE

